



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 501/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2019 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt “*Auditim i mjedisit, sigurisë dhe shëndetit në punë në të 3 (tre) njësitë prodhuese nën administrimin e KESH sh.a*”, me nr. REF-23748-05-27-2019, me fond limit 5,000,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ECCAT” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Irfan Tomini”, P.50, kati I, nr.6, Tiranë.
- Autoriteti kontraktor:** KESH sh.a.
Adresa: Rr. “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.05.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt “*Auditim i mjedisit, sigurisë dhe shëndetit në punë në të 3 (tre) njësitë prodhuese nën administrimin e KESH sh.a*”, me nr. REF-23748-05-27-2019, me fond limit 5,000,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a.

II.2. Në datën 03.06.2019, operatori ekonomik ankimues “ECCAT” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit., me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Pika 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë akreditimi për të kryer të gjitha analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006.

ANKESE: a) Cila është arsyeja që kerkohet një laborator i akredituar sipas ISO 17025:2006? Nderkohe që ky kritere skualifikon padrejtesisht laboratore të tjere të akredituar rishtazi me ISO

17025:2017, te cilet nuk kane asnje ndryshim ne cilesine e punes me labororet e permendur me larte. Te hiqet viti pas standartit ISO 17025.

b) Ne kriterin e mesiperm kerkohet qe laboratory te jete i akredituar per te kryer te gjitha analizat laboratorike. A mund te specifikohet cilat jane keto analiza? Mos valle ky kriter eshte vendosur i tille ne menyre qe te lejoje vend per interpretim dhe paracaktim te fituesit?

Pika 2.3.4 Menaxheri i cilësisë i përcaktuar në çertifikatën e akreditimit duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit Janar 2019. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqiten listëpagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.

ANKESE: a) A ka mundesi te na sqaroni se pse kriter eshte menaxheri i cilesise i deklaruar ne certifikaten e akreditimit te jete i punesuar pikerisht qe prej Janarit 2019? Ne rastet kur ky menaxher cilesie eshte larguar nga puna dhe eshte zevendesuar me nje te ri, te cilet ne te dy rastet per periudhen kur kane mbajtur pozicionin e menaxherit jane te deklaruar tek tatimet, por jo per faj te laboratorit, Drejtoria e pergjithshme e akreditimit nuk ka perditesuar Certifikata: e akreditimit me ndryshimet e reja, ky kriter perben skualifikim? Kerkojme te hiqet ky kriter diskriminues i cili paracakton fituesin dhe eshte vene vetem per te demtuar laboratorin tone.

Kerojme te hiqet ky kriter mbi menaxherin e cilesise se laboratorit i cili nuk ka asnje lidhje me auditimin dhe sherbimin e kerkuar pervecse paracaktim te fituesit. Laboratori i akredituar dhe menaxheri i cilesise se laboratorit quhen te tille sepse kane kualifikimet e posacme per ISO 17025 dhe nderkohe sherbimi i auditimit kerkohet per ISO 14001:2015 dhe OHSAS 18001:2007, ky kriter eshte vendosur vetem per arsye diskriminimi dhe skualifikimi dhe per asnje arsye apo kerkese tjeter teknike pasi sic eshte shpjeguar me larte nuk ndikon ne objektin e kontrates. Legjislacioni mbi akreditimin percakton qarte rregullat e menaxherit te cilesise ne labororet e akredituar. Dhe mosperditesimi i certifikates se akreditimit me menaxherin e ri te laboratorit nuk eshte kusht i cili mund te perbeje skualifikim, pasi nuk varet ne doren e laboratorit por te drejtorise se pergjithshme te akreditimit e cila nese do te kishte shkelje kur ka ndryshime ne staf do te bente edhe pezullimin e certifikates se akreditimit. Nese eshte kaq i nevojshem menaxheri i cilesise atehere le te jete si kriter por duhet te hiqet diskriminimi i shprehur qarte me lojera fjalesh "Menaxheri i cilesise i deklaruar ne certifikaten e Akreditimit", ky cilesim perben diskriminim dhe eshte vene vetem per te penalizuar laboratorin tone! I paracaktuari fitues eshte ne dijeni te ndyshit te struktures organizative te laboratorit tone dhe perdor kete term ne bashkepunim me AK per te skualifikuar laboratorin ECCAT. Ne termat e references nuk kerkohen kryerje analizash laboratorike. Per kete qellim nuk ka pse te kerkohet qe menaxheri cilesise dhe laboratori i akredituar te jene kriter kualifikimi. Ku bazoheni qe kerkoni kriteri qe skane asnje lidhje me termat e references te kerkuara nga AK ? Kerkojme heqjen e ketij kriteri i cili nuk kerkohet ne termat e references.

Pika 2.3.6 Operatori ekonomik Qfertes duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) ekspert për sigurinë në punë dhe 1 (një) ekspert mjedisi, të cilët të plotësojnë kriteret e mëposhtme: Për Audituesin e Sigurisë në punë dhe shëndetit :

1. Të ketë minimalisht 10 (dhjetë) vjet eksperincë në fushën e sigurisë në punë dhe shëndetit. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë CV e ekspertit.

2. Të ketë formim inxhinierik dhe të jetë çertifikuar në lidhje me BS OHSAS 18001:2007 për shëndetin dhe sigurinë në punë. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë listepagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig, diplomën dhe çertifikatën përkatëse.
3. Të ketë kryer trajnime/kurse për sigurinë dhe shëndetin. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë çertifikatat e përituara nga trajnimet kurset.
4. Të ketë eksperiencë auditimi të ngjashme në hidrocentrale.

Për Audituesin e mjedisit :

1. Të jetë diplomuar si inxhinier mjedisi dhe të ketë jo më pak se pesë vjet përvojë pune. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet diploma dhe CV e punonjes”.
2. Të jetë çertifikuar për ISO 14001:2015. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata përkatëse.
3. Të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit janar 2019. Për këtë duhet të paraqiten listepagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.
4. Të jetë i çertifikuar si ekspert mjedisi. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata e lëshuar nga Ministria përkatëse.
5. Të jetë i licënsuar pranë QKL / NLC kodit III.2.A. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata përkatëse.
6. Të ketë eksperiencë auditimi të ngjashme në hidrocentrale. Për provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet një raport auditimi/studimi/ monitorimi si dhe një deklaratë e lëshuar nga kompania që ka realizuar shërbimin.

ANKESE: a) cilat janë arsyet që në pikën 1 të kërkesës 2.3.6 për ekspertin e shëndetit dhe sigurisë në punë kërkohej vetëm CV me eksperiencë dhe në pikën 1 për kërkesat e ekspertit të mjedisit kërkohej edhe diploma e posaçme e kufizuar vetëm në inxhinier mjedisi, ? Mos vëlle ky kriter kërkon të diskriminojë pjesëmarrësit në këto tender dhe me anën e këtij kushti të paracaktojë fituesin? Kërkojmë të hiqet kërkesa e diplomes pasi në fushën e ekspertizës mjedisore mund të punojnë edhe Kimist, Inxhiniera kimist, Inxhiniera Kimika-mjedisore, inxhiniera civil, ekonomist, etj dhe përcaktimi i diplomimit për mjedis nuk i kufizon këta individë të certifikohen nga ministria e mjedisit si të tillë. Referojuni bazës ligjore për legjislacionin në mjedisin i cili nuk përcakton vetëm inxhinierin e mjedisit si ekspert mjedisi.

b) Pika 4. Të ketë eksperiencë të ngjashme të auditit në hidrocentrale është diskriminuese sepse audit kryhet në bazë të standartit OHSAS 17001 dhe ISO 14001 dhe plotësimi të kërkesave të këtyre standarteve dhe nuk lidhet me industrinë. Përse ky kriter është kërkuar nëse nuk është diskriminues vetëm për ekspertin e OHSAS 18001 dhe jo për ekspertin e ISO 14001? Përse në rastin e auditorit mjedisor ky kriter është zëvendësuar me “Të ketë eksperiencë auditimi të ngjashme në hidrocentrale. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet një raport auditimi/studimi/ monitorimi si dhe një deklaratë e lëshuar nga kompania që ka realizuar shërbimin, ku duket qartazi që qëllimisht është kërkuar të zëvendësohet eksperiencë si auditor me eksperiencë monitorimi. Eksperiencat e ngjashme kërkohej në pikën 2.3.1 të DST-ve dhe në DST përcaktohen qartë se si operatorët duhet të vërtetojnë eksperiencat e ngjashme. Kështu bazohet që kërkon eksperiencë për secilin ekspert nderkohe që është operatori ekonomik që

verteton eksperiencat sipas pikes 2.3.1? Kerkojme heqjen e ketij kriteri diskriminues dhe parapercaktues te fituesit dhe lenjen ne fuqi te kriterit 2.3.1 sipas DST-ve. [...]”

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, me anë të shkresës nr.2487prot., datë 07.06.2019, duke e pranuar pjesërisht atë, me argumentimin si më poshtë vijon:

“1. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për kriterin e kërkuar 2.3.3: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë akreditimi për të kryer të gjitha analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006 për standartin dhe për specifikën e analizave që kërkojnë të kryhen, komisioni relaton: Ky kriter lidhet ngushtë me kërkesat e Termave të Referencës pasi në auditimin e performancës së mjedisit përfshihen investimet e reja, veprimet e marra për monitorimin, parandalimin dhe minimizimin e ndikimeve në mjedis, në përputhje si më poshtë por jo të limituara tek: menaxhimi i ujërave të zeza, emetimet në ajër, ndotja e tokës, kontrolli i zhurmave, menaxhimi i materialeve të rrezikshme, menaxhimi i mbeturinave (përfshirë PCB-të dhe azbestin). Bazuar në raportin e ekspertit të mjedisit do të shihet nevoja për të kryer analizat nga laboratorit. Këto analiza janë mjaft specifike dhe kërkesa e laboratorit të akredituar është kërkuar për të vërtetuar se operatori/ët ekonomik disponojnë kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin me sukses të kësaj kontrate, për të garantuar një shërbim me cilësi. Nevoja e analizave laboratorike kërkohej duke parë specifikën që ka auditimi i këtyre faktorëve mjedisorë në të 3 (tre) njësitë e prodhimit. Në lidhje me kriterin e mësipërm përsa i përket kërkesës për përmbushjen e standartin S SH ISO/IEC 17025:2006, me qëllim mos kufizimin e operatorëve ekonomik të cilët mund të kenë zëvendësuar këtë standart, komisioni rekomandon ndryshimin e këtij kriteri si më poshtë: 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë akreditimi për të kryer të gjitha analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006, S SH ISO/IEC 17025:2006 ose S SH ISO/IEC 17025:2017.

Për sa parashtruan më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

2. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për kriterin e kërkuar 2.3.4: Menaxheri i cilësisë i përcaktuar në certifikatën e akreditimit duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit Janar 2019. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqiten listëpagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës për kërkesën e punësimit me kohë të plotë të tij dhe argumentimin në lidhje me këtë kërkesë komisioni relaton: Menaxheri i cilësisë i përcaktuar në certifikatën e akreditimit është kërkuar i punësuar me kohë të plotë, pasi ka pozicionin kyç në laborator, pa kufizur asnjë konkurent se çfarë parametrash do të maten. Kjo kërkesë bëhet për të faktuar punën dhe vazhdimësinë në nxjerrjen e konkluzioneve të standarteve të besueshme dhe të certifikuara, të mbajtjes dhe përmirësimit të sistemit të menaxhimit si dhe të identifikimit të shmangieve nga sistemi i menaxhimit ose nga procedurat. Koha prej 3 (tre) muaj e punësimit të menaxherit të cilësisë gjykohej si kohë e qëndrueshmërisë dhe rezultative e menaxherit pranë operatorit, pasi në shumicën e kontratave në kompani serioze periudha 3 (tre) mujore konsiderohet dhe si periudhë prove e të punësuarit në një kontratë pune. Kjo gjë vërtetohet me listëpagesat e kërkuara për 3 (tre) muajt e fundit, të cilat përfshijnë një periudhë minimale dhe që vërtetojnë se e ka të

punësuar dhe siguruar punonjës in sa më sipër. Komisioni gjykon se kërkesa për menaxherin e cilësisë dhe laboratorin janë të rëndësishme pasi provohet se operatorët ekonomik ofertues kryejnë aktivitet objekt prokurimi të akredituar sipas standarteve të kërkuara, për realizimin e shërbimit me cilësi dhe në kohë.

Për sa parashtruar më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

3. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për kriterin e kërkuar 2.3.6, konkretisht për pikën 1 të kërkuar Për Audituesin e Sigurisë në punë dhe shëndetit : Të ketë minimalisht 10 (dhjetë) vjet eksperiencë në fushën e sigurisë në punë dhe shëndetit. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë CV e ekspertit dhe për pikën 1 për Audituesin e mjedisit : Të jetë diplomuar si ing mjedisi dhe të ketë jo më pak se pesë vjet përvojë pune. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet diploma dhe CV e punonjësit, për të cilën ankimuesi pretendon kërkesën në lidhje me ing. E mjedisit, komisioni relaton”

Auditimi mjedisor është një proces specifik i cili kërkon njohje të shumanëshme të natyrës, shkaqeve dhe çështjeve të veçanta të ndotjes së mjedisit. Për këtë qëllim është kërkuar që audituesi mjedisor të jetë inxhinier mjedisi pasi duhet të ketë njohuri lidhur me mënyrën se si menaxhohet një auditim mjedisor, njohuri të shumanëshme të mjedisit, metodikës etj. Kërkesa për inxhinierin e mjedisit, është në përputhje me objektin, natyrën e kësaj procedure dhe termave të referencës, e cila kërkon kualifikime profesionale të stafit përgjegjës me qëllim zbatimin e kontratës në fjalë në të (3) tre njësitë e prodhimit të KESH sh.a.

Në lidhje me kërkesën për CV-në e ekspertit të shëndetit dhe sigurisë në punë, sqarojmë se kjo kërkesë ka të bëjë me pasqyrimin e eksperiencave të ekspertit në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë, pavarësisht diplomimit të tij. Kjo CV detajon eksperiencën e përgjithshme, si dhe kualifikimin në disiplinën specifike për detyrat e ngarkuara dhe shërbimet e kryera në fushën e auditimit.

Përsa i përket kërkesës në pikën 2.3.6, pika 2, e kapacitetit teknik për Audituesin e Sigurisë në punë dhe shëndetit është kërkuar: “Të ketë formim inxhinierik dhe të jetë çertifikuar në lidhje me BS OHSAS 18001:2007 për shëndetin dhe sigurinë në punë. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë listepagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig, diplomën dhe çertifikatën përkatëse”. Në lidhje me kërkesën sa më sipër, Komisioni rekomandon përcaktimin më të saktë dhe të qartë të profilin e inxhinierit për kryerjen e këtij shërbimi dhe ndryshimin e këtij kriteri duke përcaktuar profilin inxhinierik: inxhinier elektrik, ing. mjedisi ose inxhinier ndërtimi. Përsa i përket kërkesës për përmbushjen e standartit OHSAS 18001:2007 me qëllim mos kufizimin e operatorëve ekonomik të cilët mund të kenë zëvendësuar këtë standart, komisioni rekomandon ndryshimin: OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001.

Për sa parashtruar më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

4. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për kriterin e kërkuar 2.3.6 pika 4 dhe pika 6 për të cilën është kërkuar në Audituesi i Sigurisë në punë dhe shëndetit të ketë eksperiencë auditimi të ngjashme në hidrocentrale dhe për Audituesin e mjedisit të ketë eksperiencë auditimi të ngjashme në hidrocentrale, Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet një raport auditimi/studimi/monitorimi, si dhe një deklaratë e lëshuar nga kompania që ka realizuar shërbimin për të cilën pretendon heqjen e këtij kriteri dhe lënien në fuqi vetëm të pikës Nr. 2.3.1 të kontratave të ngjashme komisioni relaton:

Eksperiencat në HEC-e kërkohen duke parë specifikën që ka auditimi në lidhje me përmbushjen e kushteve dhe termave që lidhen me plotësimin e kërkuar të aspekteve social mjedisore që KESH sh.a duhet të zbatojë gjatë aktivitetit të tij si prodhues, gjatë realizimit të projekteve të ndryshme të rehabilitimit të aseteve ekzistuese apo masat dhe kontrollin për parandalimin e rreziqeve kryesore ndaj të cilave ekspozohen punonjësit e KESH sh.a, që punojnë në impiantet e prodhimit të energjisë elektrike. Kërkesat për eksperiencat e ngjashme të audituesve janë vendosur në përputhje me Termat e Referencës, të cilat kanë në fokus përputhshmërinë me kërkesat ligjore, rregullat lokale dhe kombëtare si dhe me kërkesat e BERZH, të cilat janë konfirmuar dhe nga specialistë të bankës. Gjithashtu shprehem se nga monitorimi që i është bërë kësaj procedure prokurimi nga APP-ja, në sistemin e prokurimeve elektronike, kriterin në lidhje me eksperiencat e audituesëve, e cila kërkohet që të hiqet, nuk është gjetur në shkelje të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik.

Për sa parashtruar më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.”

II.4.Në datën 12.06.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.Në datën 24.06.2019, nëpërmjet shkresës me nr.2722/1prot., datë 21.06.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “ECCAT” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “Pika 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë akreditimi për të kryer të gjitha analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006. ANKESE: a) Cila eshte arsyeja qe kerkohet nje laborator i akredituar sipas ISO 17025:2006? Nderkohe qe ky kriter skualifikon padrejtesisht laboratore te tjere te akredituar rishtazi me ISO 17025:2017, te cilet nuk kane asnje ndryshim ne cilesine e punes me labororet e permendur me larte. Te hiqet viti pas standartit ISO 17025. b) Ne kriterin e mesiperme kerkohet qe laboratorit te jete i akredituar per te kryer te gjitha analizat laboratorike. A mund te specifikohet cilat jane keto analiza? Mos valle ky kriter eshte vendosur i tille ne menyre qe te lejoje vend per interpretim dhe paracaktim te fituesit?” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr.7, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:
”Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë akreditimi për të kryer të gjitha analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006.”

III.1.2. Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm, si më poshtë vijon:

Pika 2.3.3 e Kërkesave të vecanta të kualifikimit ishte:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë akreditimi për të kryer të gjitha analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006.

Pika 2.3.3 e Kërkesave të vecanta të kualifikimit bëhet:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë akreditimi për të kryer të gjitha analizat laboratorike në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006 ose S SH ISO/IEC 17025:2017.”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]” “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”

III.1.4. Në nenin 30 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.5. Referuar shkresës nr. 2487/3 prot., datë 07.06.2019 të trajtimit të ankesës së ankimuesit, autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ECCAT” sh.p.k. Konkretisht, referuar aktit të mësipërm, KPP konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor është pranuar kërkitimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me kriterin në shtojcën 7, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, mbi vitin e standartit të certifikatës. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP konstaton se, nga ana e autoritetit kontraktor është reflektuar ky ndryshim në sistemin e prokurimeve elektronike ndryshime (shtojcë e dokumenteve të procedurës së

prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e KSHA. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se kërkimet e mësipërm është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe për këtë arsye në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.6. Ndërsa lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi kërkesën e autoritetit kontraktor se operatori ekonomik duhet të jetë i akredituar për kryerjen e të gjitha analizave, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përketë rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Në rastin konkretë, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, si dhe termave të referencës të hartuara nga autoriteti kontraktor, Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar nga ky i fundit lidhur me disponueshmërinë e certifikatës të akreditimit për kryerjen e analizave laboratorike, është një kërkesë në përputhje me e lidhur ngushtë me objektin e kontratës që prokurohet. Por, kërkesa e autoritetit kontraktor se operatori ekonomik duhet të jetë i akredituar për kryerjen e të gjitha analizave, pa përcaktuar në mënyrë konkrete llojet e analizave laboratorike për të cilat ofertuesit duhet të jenë të akredituar, krijon konfuzion te këta të fundit, si dhe bie në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke përcaktuar në mënyrë konkrete llojet e analizave për të cilat ofertuesit e mundshëm duhet të jenë të akredituar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“[...]Pika 2.3.4 Menaxheri i cilësisë i përcaktuar në certifikatën e akreditimit duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit Janar 2019. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqiten listëpagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.*

ANKESE: a) A ka mundesi te na sqaroni se pse kriter eshte menaxheri i cilesise i deklaruar ne certifikaten e akreditimit te jete i punesuar pikerisht qe prej Janarit 2019? Ne rastet kur ky menaxher cilesie eshte larguar nga puna dhe eshte zevendesuar me nje te ri, te cilet ne te dy rastet per periudhen kur kane mbajtur pozicionin e menaxherit jane te deklaruar tek tatimet, por jo per faj te laboratorit, Drejtoria e pergjithshme e akreditimit nuk ka perditesuar Certifikata: e akreditimit me ndryshimet e reja, ky kriter perben skualifikim? Kerkojme te hiqet ky kriter diskriminues i cili paracakton fituesin dhe eshte vene vetem per te demtuar laboratorin tone. Kerojme te hiqet ky kriter mbi menaxherin e cilesise se laboratorit i cili nuk ka asnje lidhje me auditimin dhe sherbimin e kerkuar pervecse paracaktim te fituesit. Laboratori i akredituar dhe menaxheri i cilesise se laboratorit quhen te tille sepse kane kualifikimet e posacme per ISO 17025 dhe nderkohe sherbimi i auditimit kerkohet per ISO 14001:2015 dhe OHSAS 18001:2007, ky kriter eshte vendosur vetem per arsye diskriminimi dhe skualifikimi dhe per asnje arsye apo kerkese tjeter teknike pasi sic eshte shpjeguar me larte nuk ndikon ne objektin e kontrates. Legjislacioni mbi akreditimin percakton qarte rregullat e menaxherit te cilesise ne labororet e akredituar. Dhe mosperditesimi i certifikates se akreditimit me menaxherin e ri te laboratorit nuk eshte kusht i cili mund te perbeje skualifikim, pasi nuk varet ne doren e laboratorit por te drejtorise se pergjithshme te akreditimit e cila nese do te kishte shkelje kur ka ndryshime ne staf do te bente edhe pezullimin e certifikates se akreditimit. Nese eshte kaq i nevojshem menaxheri i cilesise atehere le te jete si kriter por duhet te hiqet diskriminimi i shprehur qarte me lojera fjalesh “Menaxheri i cilesise i deklaruar ne certifikaten e Akreditimit”, ky cilesim perben diskriminim dhe eshte vene vetem per te penalizuar laboratorin tone! I paracaktuari fitues eshte ne dijeni te ndyshimit te struktures organizative te laboratorit tone dhe perdor kete term ne bashkepunim me AK per te skualifikuar laboratorin ECCAT. Ne termat e references nuk kerkohen kryerje analizash laboratorike. Per kete qellim nuk ka pse te kerkohet qe menaxheri cilesise dhe laboratori i akredituar te jene kriter kualifikimi. Ku bazoheni qe kerkoni kriteri qe skane asnje lidhje me termat e references te kerkuara nga AK ? Kerkojme heqjen e ketij kriteri i cili nuk kerkohet ne termat e references. [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.7, pika 2.3.4 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

” Menaxheri i cilësisë i përcaktuar në certifikatën e akreditimit duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit Janar 2019. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqiten listëpagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.”

III.2.2.Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm, si më poshtë vijon:

Pika 2.3.4 e Kërkesave të vecanta të kualifikimit ishte:

Menaxheri i cilësisë i përcaktuar në certifikatën e akreditimit duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit Janar 2019. Në lidhje me këtë pikë duhet të

paraqiten listëpagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.

Pika 2.3.4 e Kërkesave të vecanta të kualifikimit bëhet:

Menaxheri i cilësisë i përcaktuar në certifikatën e akreditimit S SH ISO/IEC 17025:2006 ose S SH ISO/IEC 17025:2017 duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit Janar 2019. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqiten listëpagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.”

III.2.3.Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.4. Në nenin 28, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “5.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a)licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose

c)dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

ç)dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.2.5.Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në këtë kontekst, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme dhe e domosdoshme që të sigurohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës, disponojnë stafin e nevojshëm për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkretë, bazuar në termat e referencës të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, legjislacionin sektorial në fuqi, Komisioni gjykon se, në zbatim të kontratës objekt prokurimi, lidhur me auditimin e performancës mjedisore të autoritetit kontraktor, shfaqet i

nevojshëm akreditimi për kryerjen e analizave, pasi në termat e referencës, është parashikuar se objekt i auditimit do të jenë menaxhimi i ujërave të zeza, emetimet në ajër, ndotja e tokës, kontrolli i zhurmave, menaxhimi i materialeve të rrezikshme, menaxhimi i mbeturinave (përfshirë PCB-të dhe Azbestin), efikasiteti i zbatimit të ESAP, për të cilat është e nevojshme dhe kryerja e analizave përkatëse nga subjekte të akredituara. Bazuar në legjislacionin sektorial, për zotërimin e certifikatës të akreditimit lidhur me kryerjen e analizave laboratrike, është i domosdoshëm disponimi i menaxherit të cilësisë, emri i të cilit pasqyrohet edhe në certifikatën e akreditimit. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor se menaxheri i cilësisë duhet të jetë i përcaktuar në certifikatën e akreditimit është në përputhje të plotë me legjislacionin sektorial, në përputhje me objektin e kontratës dhe aspak diskriminuese, pasi në rast se subjekti i akredituar nuk do e dispononte më menaxherin e cilësisë të pasqyruar në certifikatë, atëherë kjo certifikatë nuk do të kishte vlerë dhe gjithashtu as menaxheri i cilësisë i pa pasqyruar në këtë certifikatë. Ndërsa lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor se menaxheri i cilësisë duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë që nga muaji Janar 2019, Komisioni gjykon se, kohëzgjatja e punës të punonjësve të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, nuk ndikon në zbatueshmërinë e kontratës, përse kohë vërtetohet se disponohet menaxheri i cilësisë, në përputhje kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit, është i punësuar pranë operatorit ekonomik në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, figuron në listëpagesa në përputhje me legjislacionin sektorial, si dhe është i pasqyruar në certifikatën e akreditimit. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor se menaxheri i cilësisë duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë që nga muaji Janar 2019, është një kërkesë kufizuese dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për të krijuar bindjen se operatorët ekonomik disponojnë kapacitetet e duhura për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke hequr përcaktimin kohor lidhur me periudhën për të cilën duhet të figurojë në listëpagesa menaxheri i cilësisë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “[...] ANKESE: a) cilat janë arsytet që ne piken 1 të kërkesës 2.3.6 për ekspertin e shëndetit dhe sigurisë në punë kerkohet vetëm CV me eksperiencë dhe ne piken 1 për kërkesat e ekspertit të mjedisit kerkohet edhe diploma e posaçme e kufizuar vetëm në inxhinier mjedisi, ? Mos valle ky kriter kerkon të diskriminojë pjesëmarrësit në këtë tender dhe me anën e këtij kushti të paracaktojë fituesin? Kerkojmë të hiqet kërkesa e diplomes pasi në fushën e ekspertizës mjedisore mund të punojnë edhe Kimista, Inxhiniera kimist, Inxhiniera Kimika-mjedisore, inxhiniera civil, ekonomist, etj dhe përcaktimi i diplomimit për mjedis nuk i kufizon këta individë të certifikohen nga ministria e mjedisit si të tilla. Referojuni bazës ligjore për legjislacionin me mjedisin i cili nuk përcakton vetëm inxhinjerin e mjedisit si ekspert mjedisi.

b) Pika 4. Të këtë eksperiencë të ngjashme të auditit në hidrocentrale është diskriminuese sepse auditit kryhet në baze të standartit OHSAS 17001 dhe ISO 14001 dhe plotësimi të kërkesave të këtyre standarteve dhe nuk lidhet me industrinë. Përse ky kriter është kerkuar nëse nuk është

diskriminues vetem per ekspertin e OHSAS 18001 dhe jo per ekspertin e ISO 14001? Perse ne rastin e auditorit mjedisor ky kriter eshte zevendesuar me “Të ketë eksperiencia auditimi të ngjashme në hidrocentrale. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet një raport auditimi/studimi/ monitorimi si dhe një deklaratë e lëshuar nga kompania që ka realizuar shërbimin, ku duket qartazi qe qellimisht eshte kerkuar te zevendesohet eksperiencia si auditor me experience monitorimi. Eksperiencat e ngjashme kerkohen ne piken 2.3.1 te DST-ve dhe ne DST percaktohen qarte se si operatoret duhet te vertetojne eksperiencat e ngjashme. Ku bazoheni qe kerkoni eksperiencia per secilin ekspert nderkohe qe eshte operatori ekonomik qe verteton eksperiencat sipas pikes 2.3.1? Kerkojme heqjen e ketij kriteri diskriminues dhe parapercaktues te fituesit dhe lenjen ne fuqi te kriterit 2.3.1 sipas DST-ve. [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr.7, pika 2.3.6 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

” 2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) ekspert për sigurinë në punë dhe 1 (një) ekspert mjedisi, të cilët të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Për Audituesin e Sigurisë në punë dhe shëndetit :

- 1.Të ketë minimalisht 10 (dhjetë) vjet eksperincë në fushën e sigurisë në punë dhe shëndetit. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë CV e ekspertit.
- 2.Të ketë formim inxhinierik dhe të jetë çertifikuar ne lidhje me BS OHSAS 18001:2007 për shëndetin dhe sigurinë në punë. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë listepagesat e shoqerise te tre muajve te fundit sipas formatit E-sig, diplomën dhe çertifikatën përkatëse.
- 3.Të ketë kryer trajnime/kurse për sigurinë dhe shëndetin. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë çertifikatat e përfutuara nga trajnimet/kurset.
- 4.Të ketë eksperiencia auditimi të ngjashme në hidrocentrale.

Për Audituesin e mjedisit :

- 1.Të jetë diplomuar si ing.mjedisi dhe të ketë jo më pak se pesë vjet përvojë pune. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet diploma dhe CV e punonjësit.
- 2.Të jetë çertifikuar për ISO 14001:2015. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata përkatëse.
- 3.Të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit janar 2019. Për këtë duhet të paraqiten listepagesat e shoqerise te tre muajve te fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.
- 4.Të jetë i çertifikuar si ekspert mjedisi. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata e lëshuar nga Ministria përkatëse.
- 5.Të jetë i liçensuar pranë QKL / NLC kodi III.2, A. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata përkatëse.
- 6.Të ketë ekperiencia auditimi të ngjashme në hidrocentrale. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet një raport auditimi/studimi/ monitorimi si dhe një deklaratë e lëshuar nga kompania që ka realizuar shërbimin”

III.3.2.Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm, si më poshtë vijon:

Pika 2.3.6 e Kërkesave të vecanta të kualifikimit ishte:

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) ekspert për sigurinë në punë dhe 1 (një) ekspert mjedisi, të cilët të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Për Audituesin e Sigurisë në punë dhe shëndetit :

1.Të ketë minimalisht 10 (dhjetë) vjet eksperincë në fushën e sigurisë në punë dhe shëndetit. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë CV e ekspertit.

2.Të ketë formim inxhinierik dhe të jetë çertifikuar ne lidhje me BS OHSAS 18001:2007 për shëndetin dhe sigurinë në punë. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë listepagesat e shoqerise te tre muajve te fundit sipas formatit E-sig, diplomën dhe çertifikatën përkatëse.

3.Të ketë kryer trajnime/kurse për sigurinë dhe shëndetin. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë çertifikatat e përfutuara nga trajnimet/kurset.

4.Të ketë eksperiencia auditimi të ngjashme në hidrocentrale.

Për Audituesin e mjedisit :

1.Të jetë diplomuar si ing.mjedisit dhe të ketë jo më pak se pesë vjet përvojë pune. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet diploma dhe CV e punonjësit.

2.Të jetë çertifikuar për ISO 14001:2015. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata përkatëse.

3.Të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit janar 2019. Për këtë duhet të paraqiten listepagesat e shoqerise te tre muajve te fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.

4.Të jetë i çertifikuar si ekspert mjedisit. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata e lëshuar nga Ministria përkatëse.

5.Të jetë i licensuar pranë QKL/NLC kodi III.2, A. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet çertifikata përkatëse.

6.Të ketë ekperiencia auditimi të ngjashme në hidrocentrale. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet një raport auditimi/studimi/ monitorimi si dhe një deklaratë e lëshuar nga kompania që ka realizuar shërbimin.

Pika 2.3.6 e Kërkesave të vecanta të kualifikimit bëhet:

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) ekspert për sigurinë në punë dhe 1 (një) ekspert mjedisi, të cilët të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Për Audituesin e Sigurisë në punë dhe shëndetit :

1.Të ketë minimalisht 10 (dhjetë) vjet eksperincë në fushën e sigurisë në punë dhe shëndetit. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë CV e ekspertit.

2.Të ketë formim inxhinierik (inxhinier ndërtimi, inxhinier elektrik ose ing mjedisit) dhe të jetë çertifikuar ne lidhje me BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001 për shëndetin dhe sigurinë në punë. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë listepagesat e shoqerise te tre muajve te fundit sipas formatit E-sig, diplomën dhe çertifikatën përkatëse.

3.Të ketë kryer trajnime/kurse për sigurinë dhe shëndetin. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqesë certifikatat e përfutuara nga trajnimet/kurset.

4.Të ketë eksperiencë auditimi të ngjashme në hidrocentrale.

Për Audituesin e mjedisit :

1.Të jetë diplomuar si ing.mjedisit dhe të ketë jomë pak se pesë vjet përvojë pune. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet diploma dhe CV e punonjësit.

2.Të jetë certifikuar për ISO 14001:2015. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet certifikata përkatëse.

3.Të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik prej muajit janar 2019. Për këtë duhet të paraqiten listepagesat e shoqërisë të tre muajve të fundit sipas formatit E-sig dhe kontrata e punës.

4.Të jetë i certifikuar si ekspert mjedisit. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet certifikata e lëshuar nga Ministria përkatëse.

5.Të jetë i licensuar pranë QKL/NLC kodi III.2, A. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet certifikata përkatëse.

6.Të ketë ekperiencë auditimi të ngjashme në hidrocentrale. Për të provuar plotësimin e këtij kushti do të paraqitet një raport auditimi/studimi/ monitorimi si dhe një deklaratë e lëshuar nga kompania që ka realizuar shërbimin.”

III.3.3. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, thuhet: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1124, datë 30.7.2008 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, i ndryshuar, pika 2, parashikohet: “2. Të drejtën për t’u pajisur me certifikatë e kanë specialistët e diplomuar në fushën e mjedisit ose të agromjedisit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në universitetet ose shkollat e larta jopublike, të akredituara për degët e sipërpërmendura ose në institucionet e huaja të arsimit të lartë që ofrojnë këto programe studimi, pas njësimit të diplomës së tyre, si dhe specialistët e diplomuar në shkencat inxhinierike, biologjike, kimike, gjeologjike, hidrologjike, ekonomike dhe gjeografike. Certifikata e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor jepet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave”

III.3.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e një inxhinieri mjedisit, Komisioni sqaron se, referuar legjislacionit sektorial dhe në mënyrë specifike, VKM nr.1124, datë 30.7.2008 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, i ndryshuar ", për kryerjen e veprimtarisë objekt prokurimi, është i nevojshëm disponimi i një eksperti mjedisit i certifikuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi, por

në asnjë rast nuk përcaktohet se detyrimisht duhet të jetë inxhinier mjedisi. Bazuar në aktin nënligjor të sipërcituar, Komisioni thekson se për t'u pajisur me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, jo domosdoshmërisht duhet të disponosh kualifikimin profesional si inxhinier mjedisi. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përcaktimi i autoritetit kontraktor se duhet të disponohet vetëm inxhinier mjedisi, është kufizues dhe diskriminues, përsa kohë eksperti mjedisor i certifikuar mund të disponojë edhe kualifikime të tjera. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke mos e kufizuar kualifikimin e ekspertit mjedisor të certifikuar.

III.3.6.Ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi kërkesën e autoritetit kontraktor, për paraqitjen e eksperiencave të mëparshme në hidrocentrale të ekspertëve auditues, Komisioni rithekson se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit, si dhe jo diskriminuese apo kufizuese. Në rastin konkretë, lidhur me vërtetimin e eksperiencave të mëparshme, Komisioni gjykon se, kjo kërkesë e autoritetit kontraktor, nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë në fuqi, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor të sigurohet që personeli i ofertuesve disponon kualifikimet dhe eksperiencat e duhura, me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës që prokurohet, por kërkesa se eksperiencat e mëparshme duhet të jenë detyrimisht auditime në hidrocentrale, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkakton kufizim të panevojshëm për operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë personel me eksperiencë të shumta në auditime, por që nuk kanë eksperiencë në auditime hidrocentralesh, ndërkohë që auditimi mjedisor dhe i sigurisë në punë, në thelb, nuk kërkon ekspertizë të posacme sipas objektit të veprimtarisë të subjektit objekt auditimi.

Ndërsa lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e eksperiencave të mëparshme të personelit, Komisioni gjykon se kjo kërkesë është në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, si dhe jo diskriminuese, me përjashtim të kërkesës për paraqitjen e deklaratës të subjektit që ka përfituar shërbimin, kërkesë e cila është e ekzagjeruar dhe aspak në varësi të operatorëve ekonomik pjesëmarrës. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke hequr kërkesat se eksperiencat e mëparshme duhet të jenë detyrimisht auditime në hidrocentrale, si dhe detyrimin për të paraqitur deklaratën e subjektit që ka përfituar shërbimin, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1, pika 2, të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Gjithashtu, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke përcaktuar dokumentacionin konkretë lidhur me provueshmërinë e eksperiencave të mëparshme për audituesin e sigurisë në punë dhe shëndetit, sikurse ka përcaktuar për audituesin e mjedisit, pasi mospërcaktimi në mënyrë konkrete i dokumentacionit provues për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, bie ndesh me pikën 2 të nenit 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, si dhe përbën shkak për konfuzion si te operatorët ekonomik pjesëmarrës, ashtu edhe te komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë procesit të vlerësimit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ECCAT” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt “*Auditim i mjedisit, sigurisë dhe shëndetit në punë në të 3 (tre) njësitë prodhuese nën administrimin e KESH sh.a*”, me nr. REF-23748-05-27-2019, me fond limit 5,000,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “ECCAT” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1074 Protokoli, Datë 12.06.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha